



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
-AUTORITETI I KONKURRENCËS-

NJOFTIM PËR SHTYP

Mbi autorizimin e përqëndrimit nëpërmjet Vienna Insurance Group AG dhe Interlbanian Sh.a

Në mbledhjen e datës 23 Nëntor, Komisioni i Konkurrencës shqyrtoi raportin mbi autorizimin e përqëndrimit të realizuar nëpërmjet shitblerjes së 75 % +1 të kapitalit aksionar me të drejtë vote të shoqërisë Interlbanian Sh.a nga shoqëria Vienna Insurance Group AG.

Përqëndrimi i realizuar konsiston në ndryshimin e kontrollit të shoqërisë Interlbanian Sh.a dhe shoqëria Vienna Insurance Group AG përfiton kontrollin e vetëm në këtë të fundit nëpërmjet shit-blerjes së aksioneve.

Transaksioni i realizuar ndërmjet palëve pjesëmarrëse në kuptim të nenit 10/1/b të Ligjit është ndryshim kontrolli në formën e ndryshimit të pronësisë dhe hyrjes së një aksioneri të ri kontrollues. Gjithashtu përqëndrimi i realizuar përmbush edhe kushtet e nenit 12 të Ligjit për sa i përket xhirove(neni 12/1).

Pas realizimit të përqëndrimit, struktura e tregut nuk ndryshon pasi në kuptim të nenit 10, pika 1, gërma b kemi zëvendësim të pronësisë dhe blerësi do të ruajë dhe do të ndihmojë në zhvillimin e profilit tregtar të shoqërisë I Interlbanian Sh.a.

Nga Vlerësimi i konkurrencës pas përqëndrimit rezultoi se tregu i sigurimeve është një treg i rregulluar me dinamikë të lartë zhvillimi që karakterizohet nga ndryshime të shpeshta në paketën kontrolluese të ndërmarrjeve prezente, kryesisht nga shoqëri sigurimesh nga vendet europiane.

Përqëndrimi I realizuar ka tregje të prekura pasi Viena Insurance Group zotëron paketën kontrolluese të aksioneve në shoqërinë Sigma sh.a. Për vlerësimin e efekteve të përqëndrimit janë analizuar tregjet e prekura në tregun shqiptar të sigurimeve kryesisht në tre nën-tregje të sigurimeve të jo-jetës si tregu i sigurimeve motorike, tregu i sigurimit të pasurisë dhe tregu i sigurimit të shëndetit. Në rastin e përqëndrimit VIG-Interlbanian Sh.a pjesët e kombinuara të tregut janë më pak se 40 % .

Si konkluzion, përqëndrimi i realizuar nuk sjell krijimin apo fuqizimin e pozitës dominuese dhe nga analiza e tregjeve të prekura rezulton se grupi Vienna

Insurance do të zotërojë kontrollin në dy shoqëri konkurruese në nivel horizontal të tregut, Interalbanian Sh.a dhe Sigma sh.a, por nuk shfaqen shenja të kufizimit në mënyrë të ndjeshme të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti dhe për këtë arsye Komisioni i Konkurrencës vendosi të autorizojë përqendrimin të realizuar nëpërmjet shitblerjes së 75 % +1 të kapitalit aksionar me të drejtë vote të shoqërisë Interalbanian Sh.a nga shoqëria Vienna Insurance Group AG